

Çfarë duhet të dinë njujorkezët rreth vaksinave kundër COVID-19

Vaksinat e COVID-19 tani janë të disponueshme për të gjithë njujorkezët nga mosha 16 vjeç e lart.



Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigura dhe efektive.

Shkencëtarët kanë mbledhur njohuri në dekada të tëra kërkimesh për vakcina të tjera kur zhvillojnë vaksinat kundër COVID-19. Vaksinat kanë kaluar në shumë studime klinike që kanë përfshirë dhjetëra mijëra persona të moshës, racave dhe etnive të ndryshme. Këto studime kanë treguar se vaksinat janë të sigura dhe shumë efektive në mbrojtjen e personave nga sëmundja e rëndë me COVID-19, shtrimi në spital dhe vdekja. Administrata e Ushqimit dhe Barnave (Food and Drug Administration, FDA) i miratoi vaksinat për përdorim emergjent.



Vaksinat kundër COVID-19 ju jepen pa pagesë.

Të gjithë njujorkezët 16 vjeç e lart mund të vaksinohen pa pagesë. **Nuk** ka nevojë të keni sigurime ose të na tregoni statusin e imigrimit që të vaksinoheni.



Gjeni një qendër për t'u vaksinuar.

Pyesni ofruesin e kujdesit shëndetësor dhe punëdhënësin nëse ofrojnë vaksinim. Vizitoni faqen [nyc.gov/vaccinefinder](https://www.nyc.gov/vaccinefinder) ose telefononi në numrin 877-829-4692 për të gjetur një qendër vaksinimi.



Mund të përjetoni disa efekte anësore.

Efektet anësore të zakonshme janë dhimbja e krahut në vendin e vaksinës, dhimbje koke, dhimbje trupi, lodhje dhe temperaturë. Vaksinat **nuk** përmbajnë virusin që shkakton COVID-19, **nuk** ju ndryshojnë ADN-në dhe **nuk** ju infektojnë me COVID-19.



Vazhdoni të zbatoni masat paraprake.

Ne e dimë që vaksinat ju mbrojnë, por na duhet ende të mësojmë më shumë rreth mënyrës se si ndikojnë në përhapjen e virusit. Për momentin, edhe pasi të vaksinoheni, vazhdoni të qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë, ruani distancë 6 këmbë nga personat e tjerë, mbani siç duhet mbulesën për fytyrën dhe lajini duart shpesh.



Vizitoni faqen [nyc.gov/vaccinefinder](https://www.nyc.gov/vaccinefinder) ose telefononi në numrin 877-829-4692 për të gjetur një qendër vaksinimi.